

LIGJ
Nr.9975, datë 28.7.2008
PËR TAKSAT KOMBËTARE

(Ndryshuar me ligjet: nr. 10065, datë 29.1.2009; nr.10 131, datë 11.5.2009; nr.10145, datë 28.9.2009; nr.10280, datë 20.5.2010; nr.10 458, datë 21.7.2011; nr.83/2012, datë 13.9.2012; nr.120/2013, datë 18.4.2013; nr.178, datë 28.12.2013; nr. 86/2014, datë 17.7.2014; nr.157, datë 27.11.2014; nr.141/2015, datë 17.12.2015; nr.127/2016, datë 15.12.2016, nr. 68/2017, datë 27.4.2017, nr. 104/2017, datë 30.11.2017, nr. 93/2018, datë 3.12.2018, nr. 55/2019, datë 18.7.2019, nr. 86/2019, 18.12.2019, nr. 153/2020, datë 17.12.2020; nr. 151/2020, datë 17.12.2020, nr. 112/2021, datë 25.11.2021, nr. 38/2023, datën 8.6.2023; nr. 96/2023, datë 7.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

(ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)

Ky ligj përcakton llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave dhe tarifave kombëtare.

Neni 2

Përkufizime

(ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr.178, datë 28.12.2013; ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014; shtuar pika 5 me ligjin nr.141/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar shkronja "b" e pikës 5 me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016; ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 104/2017, datë 30.11.2017, shtuar paragrafë në shkronjën "b" të pikës 5 me ligjin nr. 86/2019, 18.12.2019)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Taksapagues" është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.
2. "Taksë" është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. "Tarifë" është një pagesë, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata tatimore qendrore. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mire publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.
4. "Agjent i taksave dhe tarifave" është personi i cili, sipas kërkesave të këtij ligji,

është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t'u transferuar, më pas, në Buxhetin e Shtetit, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat kombëtare.

5. "Automjet luksoz" konsiderohet autovetura deri në 6+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm³; ose

b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë.

Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPTSHRR-së, kur mjeti regjistrohet për herë të parë ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit "Automjet luksoz", reduktohet çdo vit me 10 për qind të vlerës së mbetur.

Për automjetet të cilat shiten, vlera e shitjes së tyre, për efekt klasifikimi si "Automjet luksoz", nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar, sipas paragrafit të mësipërm.

Neni 3

Llojet e taksave kombëtare

(ndryshuar pikat 3 dhe 6 me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010; ndryshuar pikat 2 dhe 6 me ligjin nr.10458 datë 21.7.2011; shtuar pika 8 me ligjin nr.83/2012, datë 13.9.2012; ndryshuar pika 8, shtuar pika 8.1 me ligjin nr.178/2013, datë 28.12.2013; shtuar pika 9 me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014; ndryshuar pikat 2, 6, shtuar pika10 me ligjin nr.157, datë 27.11.2014; shtuar pika 11 me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar pikat 2,6 me ligjin nr. ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016; ndryshuar pika 8 dhe 8/1 dhe shtuar pika 8/2 me ligjin nr. 93/2018, datë 3.12.2018, shtuar pikat 12-16 me ligjin nr. 112/2021, datë 25.11.2021; zëvendësuar fjalë në pikën 6 me ligjin nr. 96/2023, datë 7.12.2023)

Taksat kombëtare janë:

1. Taksa portuale.

2. Taksa e qarkullimit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59) dhe për gazoilin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), si dhe për benzinën ose gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 38 26 00).

3. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.

4. Taksa e rentës minerare.

5. Taksa e akteve dhe e pullës.

6. Taksa e karbonit për benzinën (sipas kodeve të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59), për gazoilin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), për qymyrin (sipas krerëve të NKM-së 2701; 2702; 2704), për vajgurin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27 10 19 11 deri në 27 10 19 29), për solarin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68), për mazutin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68) dhe për koks nafte (sipas kodeve të NKM-së 2713 11 00; 2713 12 00), si dhe për benzinën ose gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 38 26 00).

7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit.

8. Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi.

8/1. Materiale/artikuj plastikë konsiderohen mallrat e importuara sipas kapitullit 39 të NKM-së.

8/2. Ambalazh plastik/qelqi është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, me qëllim

mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.

9. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim.

10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil.

11. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze.

12. Taksë për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur, të përfshirë në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së.

13. Taksë për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara, të përfshirë në kodet 0404 90 21, 0404 90 23 dhe 0404 90 29 të NKM-së.

14. Taksë për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit, të përfshirë në kreun 0404 10 të NKM-së.

15. Taksë për importimin dhe prodhimin e krem qumështit, të përfshirë në kreun 0402 të NKM-së.

16. Taksë për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare.

Neni 4

Niveli i taksave kombëtare

(shfuqizuar fjalia e fundit e pikës 2 dhe ndryshuar pika 6 me ligjin nr.10 065, datë 29.1.2009; ndryshuar pikat 2, 3, 4, 6 me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010; ndryshuar pikat 2, 3, 6 me ligjin nr.10 458, datë 21.7.2011; shtuar pika 8 me ligjin nr.83/2012, datë 13.9.2012; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 120/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar pikat 2, 8 me ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013; shtuar pika 9 me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014; ndryshuar pikat 2,4, shtuar pika 9 me ligjin nr.157, datë 27.11.2014; ndryshuar pikat 4, 5, 9, shtuar pika 11 me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar pikat 2,3, 4, 8, me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016; ndryshuar pika 3 e nenit 4 e ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017

“Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ndryshuar fjalë në pikën 4, shtuar një fjali në pikën 6 dhe ndryshuar pika 8 me ligjin nr. 93/2018, datë 3.12.2018, shtuar një fjali pas fjalisë së parë të pikës 8, ndryshuar fjalë në pikën 8/1 dhe riformuluar pika 8.5 me ligjin nr. 55/2019, datë 18.7.2019, ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 86/2019, 18.12.2019, shtuar paragraf në fund të pikës 4 me ligjin nr. 153/2020, datë 17.12.2020; ndryshuar fjalë në paragrafin e parë dhe të tretë të pikës 4 nr. 151/2020, datë 17.12.2020, shtuar pikat 12-16 me ligjin nr. 112/2021, datë 25.11.2021; ndryshuar pika 6 me ligj nr.96/2023, date 7.12.2023)

1. Taksa portuale është 1 euro. Kjo taksë paguhet, për çdo prekje, për të gjitha anijet që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë e që kryejnë veprime tregtare.

2. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 27 lekë/litër për benzinën dhe 27 lekë/litër për gazoilin. Kjo taksë paguhet për sasinë e benzinës dhe të gazoilit të importuar apo të prodhuar në vend, me përjashtim të sasisë së benzinës dhe të gazoilit të prodhuar në vend, por të eksportuar jashtë territorit të Shqipërisë.

3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm3 x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik

vjetor të detyrueshëm të mjetit. Kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. 25 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësisë të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore.

4. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin mineral është në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, “Grupi i parë (I) Mineralet metalike” që i bashkëlidhet këtij ligji. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklarates së eksportit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

Në rastin kur taksa e rentës minerare aplikohet në përqindje, kjo taksë llogaritet duke shumëzuar vlerën e shitjes së produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës. Kur taksa e rentës minerare aplikohet në vlerë fikse për njësi, shuma e rentës minerare llogaritet duke shumëzuar sasinë e shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare. Në rastin e shitjes së mineralit të grupit të parë (I), “Mineralet metalike”, për përpunim brenda vendit, nga nxjerrësi të përpunuesi, përqindja e rentës aplikohet në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, mbi vlerën (çmimin) e shitjes, e cila, për efekt të përlllogaritjes së rentës minerare, nuk mund të jetë më e vogël se çmimi i shitjes për eksport të mineralit të papërpunuar.

Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtimit të rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes. Masa e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin mineral, ndryshon sipas paragrafëve të parë dhe të dytë, të pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji.

Taksa e rentës minerare për hidrokarburet e nxjerra përcaktohet me ligjin “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.

5. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas shtojcës nr. 3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Taksa e karbonit caktohet në masën:

- a) 1,5 lekë për litër për benzinën;
- b) 3 lekë për litër për gazoilin;
- c) për qymyrin:
 - i. 4,5 lekë për kilogram nga data 1 korrik 2026;
 - ii. 6.5 lekë për kilogram për vitin 2027;
 - iii. 9 lekë për kilogram për vitin 2028;
 - iv. 12 lekë për kilogram për vitin 2029;
 - v. 15.3 lekë për kilogram për vitin 2030 dhe në vazhdim;
- ç) 3 lekë për litër për solarin;
- d) 3 lekë për litër për mazutin;
- dh) 3 lekë për litër për vajgurin;
- e) 3 lekë për kilogram për koks naftë.

Kjo taksë nuk paguhet për sasitë e benzinës e të gazoilit që eksportohen.

7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit caktohet sipas shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike të importuara në kapitullin 39, të NKM-së, është 35 lekë/kg, me përjashtim të lëndëve të para në forma primare, të importuara në krrerët 3901 deri në 3914, të NKM-së. Në rastet kur artikujt që importohen në kapitullin 39, të NKM-së, pjesa joplastike zë më shumë se 51 për qind të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës. Përveç kapitullit 39, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krrerët, nënkrrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

8.1 Taksa e lëndëve të para në forma primare, të importuara në krrerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, dhe që përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës është 10 lekë/kg.

8.2 Taksa e ambalazheve prej qelqi është 5 lekë/kg dhe zbatohet për ambalazhet prej qelqi të importuara e të prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi, sipas kreu 7010 të NKM-së, në rast se ambalazhi importohet veçmas, si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera, të klasifikuara në kapitujt, krrerët, nënkrrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

8.3 Në rastin e importit, taksa e materialeve/artikujve plastikë, lëndëve të para në forma primare për prodhimin e materialeve plastike, si dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi llogaritet dhe mbledhet nga administrata doganore në momentin e importit.

8.4 Në rastin e prodhimit brenda vendit, taksa e ambalazheve prej qelqi mbledhet nga administrata tatimore, sipas afateve dhe procedurave të deklarimit në këtë ligj. Administrata tatimore monitoron dhe kontrollon lëndët e para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, si dhe lëndët e para në forma primare, të importuara, me qëllim prodhimin e materialeve dhe ambalazheve plastike brenda vendit.”.

8.5 Për ambalazhet plastike/qelqi, lëndët e para, si dhe për materialet/artikujt prej plastike, të cilat eksportohen dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, administrata doganore rimbursion shumën e taksës së paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

9. Niveli i taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim, aplikimi, llogaritja dhe pagesa e saj bëhen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, të ndryshuar.

10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për

produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10 për qind e shumës së primit.

11. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit.

Taksa e përvitshme për automjetet luksoze është e vlefshme për 365 ditë. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoritë Rajonale, në momentin e vjeljes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit.

12. Taksa për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur është në vlerën 100 lekë/kg.

13. Taksa për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara është në vlerën 16 lekë/litër.

14. Taksa për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit është në vlerën 150 lekë/litër.

15. Taksa për importimin dhe prodhimin e krem qumështit është në vlerën 150 lekë/litër.

16. Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, është në vlerën 40 lekë/litri.

Neni 4/1

Deklarata për pagesën e taksave kombëtare

(shtuar me ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014; ndryshuar pika 1 ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016)

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të nenit 4, të këtij ligji, si dhe agjentët e taksave, në rastin kur taksat mbledhen me agjentë, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhet deklarimi;

b) të paguajnë taksat kombëtare për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Deklarata për pagesën e taksave kombëtare dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar personi fizik/personi juridik, subjekt i deklarimit të taksës kombëtare.

Neni 5

Agjentët e taksave

(ndryshuar shkronjat “c” “dh” me ligjin nr. nr.10280, datë 20.5.2010; ndryshuar shkronjat “b” “c” “dh” me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011; shtuar shkronja “e” me ligjin nr.83/2012, datë 13.9.2012; shtuar shkronja “f” me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014; shtuar shkronja “g” me ligjin nr.157, datë 27.11.2014; shtuar shkronja “gj” me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar shkronja “g” me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016, ndryshuar shkronja “e” me ligjin

nr. 93/2018, datë 3.12.2018, shtuar shkronjat "b-l" me ligjin nr. 112/2021, datë 25.11.2021)

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

a) për taksat portuale, kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore apo private;

b) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën dhe gazoilin e prodhuar në vend.

c) Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

ç) për taksën e rentës minerare, organet doganore e tatimore;

d) për taksën e akteve dhe të pullës, zyrat e gjendjes civile;

dh) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e karbonit për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koksin e naftës e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koksin e naftës të prodhuar në vend, në bazë të sasive të prodhimit.

e) për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit dhe degët e saj në rrethe.

ë) për taksën e materialeve/artikujve plastikë dhe taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi ngarkohen:

i) administrata doganore, në rastet e importit të materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi;

ii) administrata tatimore, në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi.

f) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive të saj rajonale, ngarkohet me mbledhjen e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror .

g) Shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ngarkohen me mbledhjen e taksës mbi primet e shkruara. Për qëllime të mbledhjes së taksës, këto shoqëri e evidentojnë atë veçmas nga primi.

gj) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

h) për taksën e importimit dhe prodhimit të qumështit pluhur, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

i) për taksën e importimit dhe prodhimit për pijet e homogjenizuara, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

j) për taksën e importimit dhe prodhimit për hirrën e qumështit, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

k) për taksën e importimit dhe prodhimit për krem qumështin, në import organet doganore dhe në prodhim organet tatimore;

l) për taksën për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, organet doganore.

Neni 6

Transferimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat kombëtare në drejtorinë rajonale tatimore dhe në llogaritë e njërive të qeverisjes vendore

(ndryshuar me ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)

Agjentët e taksave deklarojnë dhe transferojnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat për llogari të drejtorisë rajonale tatimore, në përputhje me nenet 4, 4/1 dhe 11/2, të këtij ligji. Për detyrimet e patransferuara të taksave dhe tarifave, për agjentët zbatohen sanksione në përputhje me nenin 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 7

Taksa që vilet nëpërmjet pullës

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011, ndryshuar me ligjin nr. 86/2019, 18.12.2019)

Taksa kombëtare, që vilet nëpërmjet pullës, është taksa e akteve të gjendjes civile.

Neni 8

Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave

(ndryshuar shkronja “dh” me ligjin nr.10065, datë 29.1.2009; ndryshuar shkronjat “b” “c” “dh” të pikës 2 me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010; ndryshuar shkronjat “b” “c” të pikës 2 me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011; ndryshuar pika 1, ndryshuar, fjalia e parë të pikës 2 me ligjin nr. 178, datë 28.12.2013; shtuar shkronja “ë” me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014; shtuar shkronja “j”, në pikën 2 me ligjin nr.157, datë 27.11.2014; shtuar shkronja “g”, me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar shkronja “e” e pikës 2 me ligjin nr. 93/2018, datë 3.12.2018, ndryshuar shkronja “g” me ligjin nr. 86/2019, 18.12.2019)

1. Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, dhe transferohen në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore dhe të llogarive të njëjësive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. Agjentët e taksave, për shërbimin që kryejnë, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të taksave që kanë transferuar në llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në buxhetin e njëjësive të qeverisjes vendore.

a) për taksat portuale (kapitenerisë së porteve)	2 për qind;
b) për taksën e qarkullimit,	0 për qind.
c) për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor,	5 për qind.
ç) për taksën e akteve dhe të pullës	5 për qind;
d) për taksën e rentës minerare (Royalty)	0 për qind;
dh) për taksën e karbonit,	0 për qind;
e) për taksën e materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi	0 për qind;
ë) për taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror	0 (zero) për qind;
f) për taksën mbi primet e shkruara	zero për qind;
g) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze,	5 (pesë) për qind.

3. Komisionet e përfituara përdoren:

a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;

c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

Neni 9

Përfshirjet nga pagimi i taksave kombëtare

(ndryshuar me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011; shtuar pika 1/1 me ligjin nr.120/2013, datë 18.4.2013; shtuar pika 4 me ligjin nr. 178, datë 28.12.2013; shtuar pika 4 me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014; ndryshuar shkronja "b" e pikës 1, shkronja "c", shtuar pika 6 me ligjin nr. 157, datë 27.11.2014; shtuar pika 7 me ligjin nr. 141/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar shkronjat "c", "ç" e pikës 1 dhe shkronja "c" e pikës 7 me ligjin nr.127/2016, datë 15.12.2016; shtuar fjalë në pikën 1/1, ndryshuar fjalia e parë në pikën 4, bequr nën-pikat "i"- "vii" të shkronjës "ç", shtuar fjalë në pikën 7 me ligjin nr. 93/2018, datë 3.12.2018, shtuar shkronjat "dh", "e", "ë" dhe "j" në pikën 4 me ligjin nr. 55/2019, datë 18.7.2019, shtuar fjalë në shkronjën "ç" të pikës 1 me ligjin nr. 86/2019, 18.12.2019, shtuar pika 8 me ligjin nr. 112/2021, datë 25.11.2021, ndryshuar pika 8 me ligjin nr. 38/2023, datë 8.6.2023)

1. Përfshihen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) Personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë.

c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.

ç) autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat me aftësi të kufizuara, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private;

d) makinat bujqësore.

1/1. Falen të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

2. Shfuqizuar.

3. Përfshihen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

4. Përfshihen nga pagimi i taksës së materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, sipas nenit 4:

a) importimi për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misionëve diplomatike dhe konsullore, përfshirë edhe konsujt e nderit, si dhe misionet speciale të akredituara në Shqipëri;

b) importimi për nevoja zyrtare dhe personale të organizmave ndërkombëtarë, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë e sipas limiteve dhe kushteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë formuar këta organizma ose në

marrëveshjet reciproke;

c) importimi i produkteve për qëllime të ndihmave humanitare;

ç) ambalazhet plastike të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, si më poshtë:

i) Shfuqizuar.

ii) Shfuqizuar.

iii) Shfuqizuar.

iv) Shfuqizuar.

v) kutitë e votimit;

vi) Shfuqizuar.

vii) Shfuqizuar.

viii) paketuesit për serumet, gjakun dhe barnat mjekësore;

d) ambalazhe qelqi, të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si më poshtë:

i) ampulat për barnat mjekësore;

ii) shishet për mbajtjen e serumit, gjakut dhe barnave mjekësore;

dh) ambalazhet plastike dhe qelqi, të vendosura nën regjime doganore pezulluese.

dh) lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar dhe që klasifikohen në kapitullin 39, të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuar nga këto lëndë të para janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen;

e) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS expanded polystyrene), importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (XPS extruder polystyrene), si dhe profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, artikuj të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës së energjisë;

ë) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve, si dhe importimi i materialeve/artikujve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, që përdoren në industrinë e prodhimit të mobilie;

f) lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta apo materialet celuloike, sipas kapitullit 39, të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve.

Kodet e detajuara të artikujve në kapitullin 39, të NKM-së, që përjashtohen nga taksa, sipas pikave “dh”, “e”, “ë” dhe “f” më sipër, përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

5. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror nuk zbatohet mbi trojet turistike, mbi objektet dhe trojet e pranuar në proces legalizimi apo mbi trojet shtetërore, të dhëna me qëllim investimin mbi to, të cilat rregullohen nga ligje të tjera.

Përjashtohen nga pagesa e vlerës së qirasë së truallit në përdorim, nga momenti i privatizimit, blerjes apo ndërtimit të objekteve deri në datën 7.6.2010, të gjitha subjektet apo individët që janë objekt i ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën e përdorimit të tij”, të ndryshuar, të cilët bëjnë kërkesë për privatizimin e këtij trualli dhe paguajnë në mënyrë të menjëhershme vlerën e plotë të tij.”.

6. Përjashtohen nga pagimi i taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit anijet e peshkimit. Sasitë, kushtet dhe kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda datës 15 janar 2015.

7. Përjashtohen nga pagimi i taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rugor targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë;

c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.

ç) të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze të sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

8. Subjektet e përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, si dhe subjektet e prodhimit të produkteve ushqimore të ambalazuara, të cilat kanë në përbërje të tyre qumësht pluhur të klasifikuar në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së, hirrë qumështi të klasifikuar në kreun 0404 10 të NKM-së dhe krem qumështi të klasifikuar në kreun 0402 të NKM-së, përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi vetëm për sasinë e importuar, për qëllim prodhimi, në përputhje me etiketën e produktit të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ku evidentohet sasia në përqindje të këtyre produkteve, që janë trupëzuar në produktin përfundimtar.

Në rast të përdorimit të qumështit pluhur, hirrës së qumështit dhe krem qumështit, jo për qëllimet e veta dhe me destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin përfitohet përjashtimi sipas kësaj pike, subjektet e përpunimit dhe prodhimit të këtyre produkteve detyrohen të paguajnë të gjithë vlerën e taksës për të cilën kanë përfituar përjashtimin. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, autoritetet tatimore kryejnë kontrolle periodike. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit, si dhe periodiciteti i kontrollit, sipas kësaj pike, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor.

Neni 10

Shkeljet dhe sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Tarifa shërbimi

(ndryshuar shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 2 me ligjin nr.10065, datë 29.1.2009; shfuqizuar shkronja "e" me ligjin nr.10280, datë 20.5.201; shtuar shkronja "e" me ligjin nr. 10 458, datë 21.7.2011; ndryshuar shkronja "ç" me ligjin nr. 178, datë 28.12.2013 dhe me ligjin nr. 104/2017, datë 30.11.2017)

1. Përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe:

a) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik Shqiptar;

c)) tarifë shërbimi konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit.

ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës së Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë;

d) tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT);

dh) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e kapitenerisë së porteve;

e) tarifa për shërbimet e radiokomunikimit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);

ë) tarifa e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve të më shumë se 20 personave, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, si dhe të mjeteve të transportit të mallrave me ngarkesë apo pa ngarkesë përcaktohet me reciprocitet.

f) tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

2. Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.

Neni 11/1

Përfshirjet nga pagesa e tarifave të shërbimit

(Shtuar me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010)

1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar, apo statusin e të verbrit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, përfshihen nga:

a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik;

c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;

ç) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Personat e sipërpërmendur nuk i përfshihen këto përjashtime nëse kryejnë veprimtari private si persona fizikë apo juridikë.

Neni 11/2

Deklarata për pagesën e tarifave kombëtare

(Shtuar me ligjin nr. 86/2014, datë 17.7.2014)

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të pagesës së tarifave kombëtare, në përputhje me nenin 11, të këtij ligji, si dhe agjentët e tarifave kombëtare, në rastin kur tarifatat mbledhen me agjentë, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajnë tarifën kombëtare për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar personi fizik/personi juridik, subjekt i deklarimit të tarifës kombëtare.

Neni 12

Shfuqizimet

Ligji nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 13

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(shtuar me ligjin nr.83/2012, 13.9.2012)

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë paguar, pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit, sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe janë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së taksave të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Administrata tatimore dhe ajo doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

Dispozita kalimtare

(shtuar me ligjin nr.120/2013, 18.4.2013))

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë pronarët e mjeteve, që nuk kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura, paguajnë sipas këtij ligji. Në rast se pagesa bëhet brenda datës 30 qershor 2013, ata përjashtohen edhe nga penalitetet për vonesë në pagesën e taksave. Aplikimi i penalitetit për vonesë në pagesën e taksave, për të gjitha mjetet, që u ka kaluar afati i vlefshmërisë së taksave, pavarësisht kur e kanë kryer pagesën e taksave, fillon nga data 1 janar 2014.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5862, datë 1.8.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bamir Topi

SHTOJCA NR. 1
KOEFIÇIENTËT SIPAS VJETËRSISË PËR TAKSËN VJETORE TË MJETET TË
PËRDORURA
(ndryshuar me ligjin nr.10 458, datë 21.7.2011)

Motomjete, autovetura, automjete për transport të përzier		Të gjitha llojet e tjera të mjeteve		Autobusët	
Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit
1	0,00	1	0,00	1	0,00
2	0,00	2	0,00	2	0,00
3	0,00	3	0,00	3	0,00
4	0,18	4	0,20	4	0,07
5	0,19	5	0,22	5	0,08
6	0,20	6	0,24	6	0,09
7	0,21	7	0,26	7	0,10
8	0,22	8	0,28	8	0,11
9	0,23	9	0,30	9	0,12
10	0,24	10	0,32	10	0,13
11	0,28	11	0,34	11	0,14
12	0,32	12	0,36	12	0,15
13	0,36	13	0,38	13	0,16
14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20
16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

Shënim. Pas vitit të 24-t të përdorimit, për autobusët koeficienti rritet me 0,03 dhe për të gjitha mjetet e tjera rritet me 0,0, ndërsa për motomjetet, autoveturat, automjetet për transport të përzier rritet me 0,04.

SHTOJCA NR. 2
RENTA MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT

*(ndryshuar me ligjin nr.10280, datë 20.5.2010; nr.141/2015, datë 17.12.2015;
nr.127/2016, datë 15.12.2016, ndryshuar pika 4 e grupit I me ligjin nr. 93/2018, datë 3.12.2018,
shfuqizuar grupi i shtatë me ligjin nr. 153/2020, datë 17.12.2020)*

Nr.	Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit minerar	Përqindja e rentës minerare
Grupi i parë (I) MINERALET METALIKE		
1	Mineralet e Argjendit	10 %
2	Mineralet e Arit	10 %
3	Mineralet e Bakrit	6 %
4	Mineralet e Kromit për eksport	7 % duke filluar nga data 1 janar 2019, 8 % duke filluar nga data 1 janar 2020, dhe 9 % duke filluar nga data 1 janar 2021 dhe në vijim.
5	Mineralet e Nikelit (nikel-silikat)	6 %
6	Mineralet e Hekurit (hekur-nikeli)	5 %
7	Mineralet Plumbit	5 %
8	Mineralet e Zinkut	7 %
9	Gjithë mineralet e tjera metalike	4 %
Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE		
10	Të gjitha mineralet jometalike	4 %
Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET		
11	Qymyret	19 940 lekë/ton
12	Bitumet	2 371 lekë/ton
13	Rërat bituminoze	117 lekë/m ³
14	Reshpet naftore	117 lekë/m ³
15	Pirobitumet	186 lekë/ton
16	Qymyr guri	200 lekë/ton
Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT		
17	Graniti	5 850 lekë/m ³
18	Gëlqerorët	47 lekë/m ³
19	Gabrot	47 lekë/m ³
20	Bazaltet	73 lekë/ton
21	Konglomerate	7 %
22	Mermeri	4 095 lekë/m ³

23	Pllakat e ndërtimit	
23.1	<i>Pllaka guri</i>	228 lekë/m ³
23.2	<i>Pllaka ranore</i>	1 456 lekë/m ³
23.3	<i>Pllaka graniti</i>	6 825 lekë/m ³
23.4	<i>Pllaka mermeri</i>	4 550 lekë/m ³
23.5	<i>Pllaka të tjera</i>	6 000 lekë/ton
24	Pllagjiogranitet	5 %
25	Ranoret	491 lekë/m ³
26	Serpentinitet	47 lekë/m ³
27	Travertinat	2 925 lekë/m ³
28	Traktolitet	2 925 lekë/m ³
29	Gips	21 lekë /ton
30	Alabastër	423 lekë/m ³
31	Argjila (prodhim çimento, tjegulla, tulla etj.)	15 lekë/ton
32	Argjila (prodhim diga hidrocentrali)	104 lekë/m ³
33	Argjil (për prodhim qeramike)	23 lekë/ton
34	Rërë lumi	98 lekë/m ³
35	Inerte lumore	42 lekë/m ³
36	Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt	104 lekë/m ³
Grupi i pestë (V) GURËT E ÇMUAR		
37	Gjithë mineralet e grupit të pestë	10 %
Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSMË TË ÇMUAR DHE OPALI		
38	Gjithë mineralet e grupit të gjashtë	10 %

SHTOJCA NR.3
TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS
(ndryshuar me ligjin nr.10145, datë 28.9.2009, nr.141/2015, datë 17.12.2015)

	MASA E TAKSËS
1. Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit	50 lekë
2. Për lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja	200 lekë
3. Për regjistrimin e shtetasve të huaj pas dhënies së shtetësisë shqiptare	2 000 lekë
4. Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit	1 000 lekë

5. Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës 1 000 lekë
 6. Për procedurën për veçim/bashkim familjeje 1 000 lekë

SHTOJCA NR.4
TAKSA VJETORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
PESHKIMIT

	Lekë në vit
I. Peshkimi detar (për 1 anije)	
1. Peshkimi detar fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- anije mbi 410 HP	80 000
2. Peshkimi pellagjik me tratavolante:	
- anije 160-200 HP	20 000
- anije 201-410 HP	30 000
- anije mbi 410 HP	40 000
3. Peshkimi pellagjik me rrethime:	
- anije 80-200 HP	10 000
- anije 201-410 HP	20 000
- anije mbi 410 HP	30 000
4. Peshkimi pellagjik dhe fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	60 000
- anije mbi 410 HP	90 000
5. Peshkimi me mjete selektike:	
- anije 40 - 80 HP	15 000
- anije 81-160 HP	25 000
- anije 161-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- anije mbi 410 HP	80 000
6. Peshkimi i molusqeve bivalvore (i autorizuar)	60 000
II. Peshkimi artizanal me mjete të lehta:	
1. Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor deri në 40HP)	7 000
2. Peshkimi në lagunat bregdetare:	
- në lagunë (1 lundror)	10 000
- në dajlane (1 peshkatar)	12 000
3. Peshkimi në ujëra të brendshme:	
- aktiv (1 lundror)	5 000
- në dajlane e prita (1 peshkatar)	8 000
4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore me mjete të lehta (gabie) për 1(një) peshkatar	20 000
III. Peshkimi sportiv në det me mjete lundruese (për 1 mjet)	40 000

IV. Akuakultura:

1. Kultivimi i midhjeve për një impiant	10 000
2. Kultivimi i peshqve me impiante në det, në liqene, në rezervuarë	1 000
3. Akuakulturë me impiante në tokë	10 000

Shënim: Për anijet e huaja që marrin licencë peshkimi në ujërat tona territoriale, taksa e lejes së ushtrimit të veprimtarisë është sa dyfishi i anijeve shqiptare. Nuk i nënshtrohen kësaj takse anijet e autorizuara nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (Drejtoria e Politikave të Peshkimit), që do të peshkojnë për qëllime studimore e shkencore.

ANEKSE TË SHTUARA ME LIGJIN NR. NR. 83/2012, DATË 13.9.2012

Aneksi 1

Ambalazhet njëpërdorimshe të plastikës

Mallrat e përcaktuara me kode tarifore:

Kodi tarifor	Emërtimi
3923	Artikuj njëpërdorimësh për mbajtjen apo paketimin e mallrave prej plastike
392410	Pajisjet e tavolinës të kuzhinës, prej plastike: vetëm enët/pajisjet njëpërdorimshe

Kodet e mallrave të cilat mund të importohen ose prodhohen me ambalazh plastik njëpërdorimësh:

Kodi tarifor	Emërtimi
Kapitulli 04	Produktet bulmetore, vezët e zogjve, mjalti natyral, produktet e ngrënshme me origjinë prej kafshëve
Kapitulli 09	Kafe çaj dhe mate
1507 – 1518	Vajrat vegjetale ose jo
Kapitulli 16	Përgatitjet ushqimore me përmbajtje mishi, peshku
1806	Përgatitje ushqimore me përmbajtje kakao
1901	Ushqimet për fëmijë
2007, 2009	Reçel, marmalata, lëngjet e frutave
Kapitulli 21	Ekstraktet e kafesë dhe ato të çajit në ambalazhe qelqi të njësive të ndryshme, salcat, majoneza, bitera dhe erëza të përziera, akullore
Kapitulli 22	Pijet, alkoolët dhe uthullat
2710	Vajrat e naftës në njësi të shitjes me pakicë në ambalazh plastik
3207, 3208, 3209, 3210, 3212	Bojërat për lyerje, pigmente dhe lustruesit
3305	Shampot
3401, 3405, 3506	Sapunët e lëngshëm, lustrues dhe kremrat
3402	Detergjentet
3403	Lubrifikuesit apo vajra të tjera me përdorim tek automjetet
3814	Solventet e holluesit

3819	Lëngje për frenat, transmisionet hidraulike etj. në ambalazhe plastike
------	--

Aneksi 2

Ambalazhet njëpërdorimshe të qelqit

Mallrat e përcaktuara me kode tarifore:

Kodi tarifar	Emërtimi
7010	Artikuj njëpërdorimësh për mbajtjen apo paketimin e mallrave prej qelqi

Kodet e mallrave të cilat mund të importohen ose prodhohen me ambalazh prej qelqi njëpërdorimësh:

Kodi tarifar	Emërtimi
0401 – 0404	Qumështi, kosi apo nënprodukte të tyre të importuara apo të prodhuara në njësi ambalazhimi të shitjes me pakicë prej qelqi
0409	Mjalti
1507 – 1518	Vajrat vegjetale ose jo
1604 – 1605	Konserva peshku apo të kafshëve të tjera të ujit
1806	Çokokrem
1901	Qumësht pluhur për kafe dhe kapuçino
Kapitulli 20	Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të bimëve (turshi, komposto, reçel, pure, lëng frutash etj.)
2101, 2103, 2105, 2106	Ekstraktet e kafesë dhe ato të çajit në ambalazhe qelqi të njësisë të ndryshme, salcat, majoneza, bitera dhe erëza të përziera, akullore
2309	Ushqim për kafshët
Kapitulli 22	Pijet, alkoollet dhe uthullat
2309	Ushqim për kafshët
3303	Parfume dhe ujëra tualeti
3406	Qirinj dekorativë